

PEACE CORPS

**Agreement between the
UNITED STATES OF AMERICA
and ALBANIA**

Signed at Tirana July 22, 2003



NOTE BY THE DEPARTMENT OF STATE

Pursuant to Public Law 89—497, approved July 8, 1966
(80 Stat. 271; 1 U.S.C. 113)—

“ . . .the Treaties and Other International Acts Series issued under the authority of the Secretary of State shall be competent evidence . . . of the treaties, international agreements other than treaties, and proclamations by the President of such treaties and international agreements other than treaties, as the case may be, therein contained, in all the courts of law and equity and of maritime jurisdiction, and in all the tribunals and public offices of the United States, and of the several States, without any further proof or authentication thereof.”

ALBANIA

Peace Corps

*Agreement signed at Tirana July 22, 2003;
Entered into force October 9, 2003.*

AGREEMENT
BETWEEN
THE GOVERNMENT OF THE UNITED STATES OF AMERICA
AND
THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA
CONCERNING THE PROGRAM OF THE PEACE CORPS IN THE
REPUBLIC OF ALBANIA

The Government of the United States of America and the Government of the Republic of Albania, recognizing the importance of developing mutually advantageous relationships and cooperation between their countries, have agreed as follows:

ARTICLE I

1. The Government of the United States shall furnish such Peace Corps Volunteers as may be requested by the Government of the Republic of Albania and approved by the Government of the United States to perform mutually agreed tasks in Albania.
2. The Volunteers shall work under the immediate supervision of governmental and private organizations in Albania designated by the two governments.
3. The Government of the United States shall provide training to enable the Volunteers to perform their tasks in the most effective manner.
4. The Government of the Republic of Albania shall bear such share of the costs of the Peace Corps program incurred in Albania as the two governments may agree.

ARTICLE II

1. The Government of the Republic of Albania shall accord equitable treatment to the Volunteers and personnel performing functions under contract with the Peace Corps and their dependents and property; accord them and their property full aid and protection, including treatment equal to or better than that accorded to nationals of the United States residing in Albania; and fully inform, consult, and cooperate with representatives of the Government of the United States with respect to all matters concerning them.

2. The Government of the Republic of Albania shall exempt the Volunteers and persons performing functions under contract with the Peace Corps who are not citizens or permanent residents of Albania from all taxes on payments that they receive to defray their living costs, on income derived from their Peace Corps work, and on income from other sources outside Albania; from all customs duties or other charges on their personal property introduced into Albania for their own use; and from all other taxes or other charges (including immigration/visa fees), except license fees. The Government of the Republic of Albania shall issue residence permits and visas (including multiple-entry visas), without fee or other charge, to Volunteers and persons performing functions under contract with the Peace Corps.

ARTICLE III

1. The Government of the United States shall provide the Volunteers, the Peace Corps Representative, and staff of the Representative with such limited quantities of equipment and supplies as the two governments may consider necessary to enable the Volunteers to perform their tasks effectively.
2. The Government of the Republic of Albania shall exempt from all taxes (including value-added taxes), customs duties, and other charges all equipment, supplies, and other goods and services introduced into or acquired in Albania by the Government of the United States, or any contractor financed by it, for use as provided under this agreement.

ARTICLE IV

1. To enable the Government of the United States to discharge its responsibilities under this agreement, the Government of the Republic of Albania shall receive a Peace Corps Representative and such staff of the Representative (including employees and contractor personnel as designated by the Peace Corps Representative), and members of their families forming part of their households, as are acceptable to the Government of the Republic of Albania. Notwithstanding the provisions of any other agreement, the Government of the Republic of Albania shall exempt such persons, and members of their families forming part of their households, who are not citizens or permanent residents of Albania from all taxes on income derived from their Peace Corps work or other sources outside Albania, from all customs duties and other charges on their personal property introduced into Albania for their own use, and from all other taxes or other charges (including immigration/visa fees), except license fees. In addition, such persons, and members of their families forming part of their households, shall be accorded status equivalent to that accorded administrative and technical staff personnel of the diplomatic mission of the United States, except they shall not be accorded immunities.

2. The Government of the Republic of Albania shall issue residence permits and visas (including multiple-entry visas), without fee or other charge, to the Peace Corps Representative, staff, and individuals performing functions under this agreement, and members of their families forming part of their households.

ARTICLE V

The Government of the Republic of Albania shall exempt from deposit requirements and currency controls all funds introduced into Albania for use in accordance with this agreement by the Government of the United States or contractors financed by it. Such funds shall be convertible into the currency of Albania at the highest rate that is not unlawful in Albania, and shall not be subject to requirements that they be invested.

ARTICLE VI

1. Authorized representatives of the two governments may from time to time make such arrangements with respect to Peace Corps Volunteers and Peace Corps programs in Albania as appear necessary or desirable for the purpose of implementing this agreement.
2. Any disputes arising under this agreement shall be resolved amicably by the two governments.

ARTICLE VII

The undertakings of each government herein are subject to the availability of funds.

ARTICLE VIII

This agreement may be amended from time to time by mutual consent of the two governments. Any such amendment shall be in writing. In the event of a conflict between this agreement and a future agreement regarding cooperation to facilitate assistance, this agreement shall prevail concerning the Peace Corps program.


ARTICLE IX

This agreement shall enter into force upon an exchange of notes confirming that each party has completed the necessary domestic legal requirements to bring the agreement into force. It shall remain in force until ninety days after the date of the written notification from either government to the other of its intention to terminate the


agreement. This agreement supercedes the November 19, 1991, Agreement Between the Government of the Republic of Albania and the Government of the United States of America Concerning the Program of the Peace Corps of the United States in the Republic of Albania, which shall terminate upon entry into force of this agreement.

Done at Tirana, Albania, on 22 July 2003, in duplicate in the English and Albanian languages, each text being equally authentic.

**FOR THE GOVERNMENT OF THE
UNITED STATES OF AMERICA:**

A handwritten signature in black ink, appearing to read "James J. Owens", written over a faint, illegible typed name.

**FOR THE GOVERNMENT OF THE
REPUBLIC OF ALBANIA:**

A handwritten signature in black ink, consisting of stylized, overlapping loops and lines.

MARRËVESHJE

NDËRMJET

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

NË LIDHJE ME PROGRAMIN E KORPUSIT TË PAQES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës duke njohur rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë e të dobishëm mes vendeve të tyre, kanë rënë dakort si vijon:

NENI I

1. Qeveria e Shteteve të Bashkuara do të ofrojë Vullnetarë të Korpusit të Paqes ashtu siç mund të kërkojë Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe të aprovuara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara për të kryer detyra në Shqipëri, për të cilat është rënë dakort reciprokisht.
2. Vullnetarët do të punojnë nën mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të organizatave qeveritare dhe private në Shqipëri të përcaktuara nga të dy qeveritë.
3. Qeveria e Shteteve të Bashkuara do të ofrojë trajnim për t'i aftësuar Vullnetarët që të realizojnë detyrat e tyre në mënyrën më efektive.
4. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përballojë pjesë të kostos së Programit të Korpusit të Paqes në Shqipëri, siç do të mund të bihet dakort ndërmjet të dy qeverive.

NENI II

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'u akordojë trajtim të barabartë Vullnetarëve dhe personelit të cilët kryejnë funksione me kontratë për Korpusin e Paqes si dhe personave të varur prej tyre dhe pronës së tyre; do t'u akordojë atyre dhe pronës së tyre ndihmë dhe mbrojtje të plotë, përfshirë trajtim të barabartë ose më të mirë sesa ai

që u akordohet shtetasve të Shteteve të Bashkuara të cilët janë rezidentë të Shqipërisë; si dhe do të informojë, do të konsultohet dhe do të bashkëpunojë plotësisht me përfaqësues të qeverisë së Shteteve të Bashkuara, në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ta.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i përjashtojë Vullnetarët dhe personat që kryejnë funksione të kontraktuar me Korpusin e Paqes, të cilët nuk janë qytetarë apo rezidentë të përhershëm të Shqipërisë, nga të gjitha taksat ndaj pagesave që ata marrin për të përballuar koston e tyre të jetesës si dhe ndaj të ardhurave të marra për punën e tyre me Korpusin e Paqes dhe të ardhurat e marra nga burime tjera jashtë Shqipërisë; nga të gjitha tarifatat doganore dhe pagesa të tjera mbi pronën personale që sillen në Shqipëri për t'u përdorur prej tyre; si dhe nga të gjitha taksat e tjera dhe pagesat (përfshi taksën e vizave/emigracionit), përveç taksave për liçensat. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të japë leje qëndrimi dhe viza (përfshi viza me shumë hyrje-dalje), pa pagesë ose detyrime të tjera, për Vullnetarët dhe personat të cilët kryejnë funksione me kontratë për Korpusin e Paqes.

NENI III

1. Qeveria e Shteteve të Bashkuara do t'i pajisë Vullnetarët, Përfaqësuesin e Korpusit të Paqes, dhe stafin e Përfaqësuesit, me sasi të kufizuara pajisjesh dhe furnizimesh të cilat mund të konsiderohen të nevojshme nga dy qeveritë për të bërë të mundur që Vullnetarët të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë efektive.
2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përjashtojë nga të gjitha taksat (përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar), detyrimet doganore dhe detyrime të tjera, të gjitha paisjet, furnizimet, dhe mallrat e shërbimet e tjera që janë sjellë ose janë blerë në Shqipëri nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara ose çdo kontraktues që financohet prej saj, për përdorimin e parashikuar në këtë marrëveshje.

NENI IV

1. Për të mundësuar Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj marrëveshjeje, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të pranojë një Përfaqësues të Korpusit të Paqes dhe stafin e këtij Përfaqësuesi, (përfshirë të punësuarit dhe personelin me kontratë të caktuar nga Përfaqësuesi i Korpusit të Paqes), dhe anëtarët e familjeve të tyre të cilët do të bashkëjetojnë me ta siç do të jenë të pranueshëm për qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Pavarësisht nga dispozitat e ndonjë marrëveshjeje tjetër, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i përjashtojë këta persona dhe anëtarët e familjeve të tyre, me të cilët bashkëjetojnë, dhe të cilët nuk janë nënshtetas apo rezidentë të përhershëm të Shqipërisë, nga të gjitha taksat mbi të ardhurat e përfituara nga puna e tyre për Korpusin e Paqes apo burime të tjera jashtë Shqipërisë, nga të gjitha tarifatat doganore dhe pagesa të tjera mbi pronën e tyre

personale të sjellë në Shqipëri për përdorimin e tyre, si dhe nga të gjitha taksat apo pagesat e tjera (përfshi taksën e vizave/emigracionit), përveç tarifave për liçensat. Po kështu, këtyre personave, dhe anëtarëve të familjeve të tyre, me të cilët bashkëjetojnë, do t'u akordohet status i njëjtë me atë që i akordohet stafit të personelit administrativ dhe teknik të misionit diplomatik të Shteteve të Bashkuara, me përjashtimin që nuk do t'u akordohen imunitetet.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të japë leje qëndrimi dhe viza (përfshi viza me shumë kalime), pa taksa apo pagesa të tjera, për Përfaqësuesin e Korpusit të Paqes, stafin, dhe individët që kryejnë funksione në bazë të kësaj marrëveshjeje, si dhe për anëtarët e familjeve të tyre, me të cilët bashkëjetojnë.

NENI V

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përjashtojë nga kërkesat për depozitim dhe nga kontrolli valutor, të gjitha fondet e futura në Shqipëri për përdorim, në përputhje me këtë marrëveshje, nga ana e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara ose kontraktorëve të financuar prej saj. Fonde të tilla do të jenë të konvertueshme në valutën e Shqipërisë, në vlerën më të lartë që nuk është e jashtëligjshme në Shqipëri, dhe nuk do t'u nënshtrohen kërkesave që ato të investohen.

NENI VI

1. Përfaqësues të autorizuar të dy qeverive mund të bëjnë herë pas here rregullime për Vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe Programet e Korpusit të Paqes në Shqipëri, siç mund të paraqitet e nevojshme ose e dëshirueshme, me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshjeje.
2. Çdo diskutim që mund të rrjedhë nga kjo marrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore nga dy qeveritë.

NENI VII

Ndërmarrjet e secilës qeveri të përmendur këtu varen nga fondet në dispozicion.

NENI VIII

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet kohë pas kohë me pëlqimin e përbashkët të të dy qeverive. Çdo amendament i tillë do të jetë me shkrim. Në rast të një konflikti ndërmjet kësaj marrëveshjeje dhe një marrëveshjeje të ardhshme në lidhje me bashkëpunimin për


lehtësimin e asistencës, kjo marrëveshje do të mbizotërojë për sa i përket programit të Korpusit të Paqes.

NENI IX

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi pas shkëmbimit të notave që do të konfirmojnë se secila palë ka përfunduar procedurat e nevojshme të legjislacionit të brendshëm për hyrjen e marrëveshjes në fuqi. Marrëveshja do të qëndrojë në fuqi deri nëntëdhjetë ditë mbas datës së lajmërimit me shkrim së njëres prej qeverive drejtuar tjetrës me synimin për dhënien fund të marrëveshjes. Kjo marrëveshje mbizotëron mbi Marrëveshjen e 19 nëntorit 1991, "Marrëveshje Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Lidhje me Programin e Korpusit të Paqes të Shteteve të Bashkuara në Republikën e Shqipërisë", e cila do të marrë fund me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Përfunduar në Tiranë, Shqipëri më datë 22 Korrik 2003, në dy kopje, në gjuhët anglisht dhe shqip, duke qenë të dyja tekstet autentike.

**PËR QEVERINË E SHTETEVE
TË BASHKUARA TË AMERIKËS**



**PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

